

KUSHTE TE PERGJITHSHME KONTRATE KREDIE Nr.

Nënshkruar sot, më datë , mes palëve:

HUADHËNËS: "IuteCredit Albania" (me poshte ICA) sh.a, Institucion Financiar Jobankë, regjistruar ne 04 gusht 2014 ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. NIPT L42011023U, me Licencë të Bankes se Shqiperise Nr. 32, datë 31.03.2015, përfaqësuar nga Akan Ajdini,

KREDIMARRËS: z/znj. , lindur më , banues në adresën: , me adresë e-mail nr ; me numer telefoni nr me Pasaporte Nr./ID Nr. , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Palët kanë rënë dakord për përpilimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate me termat e mëposhtme:

Neni 1. Baza Ligjore dhe Statusi Juridik

1.1 Kjo Kontratë hartohet bazuar në nenet 6, 24, 31, 419 e vijues, 659 e vijues, 1050 e në vazhdim të Kodit Civil.

1.2 Kontrata parashikon kushtet e pergjithshme te marrëdhënieve mes palëve, te drejtat dhe detyrimet reciproke e tyre që do te plotesohen pas nënshkrimit të Kontratës Specifike të Huase Personale dhe/ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta.

1.3 Huamarrësi nuk mund të jetë palë në asnjë Kontratë Specifike të Huase Personale ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta nëse nuk ka firmosur paraprakisht këtë kontratë.

1.4 Huamarrësi nuk mund t'ia transferojë të tretëve huanë/huatë dhe te drejtat e lidhura me ate/ato.

1.5 Huadhënësi ka të drejtë të trasferojë tek cdo palë e tretë, vendase apo të huaj, pa marrë miratimin paraprak të Huamarrësit, këte kontratë së bashku me Kontratën Specifike të Huasë Personale dhe/ose të Kontratës së Huasë për Blerje të Veçanta.

Neni 2. Objekti i Kredisë

2.1 ICA bie dakort qe t'i jape Huamarrësit hua dhe Huamarrësi pranon t'i paguajë ICA, përveç shumës së huase edhe detyrimet që lindin nga kontrata e huase, në përputhje me planin e shlyerjes përcaktuar në Kontratën Specifike të Huase Personale dhe/ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta: principalin (vlerën moninale të huase), interesin e përllogaritur të huase, komisionin, tarifat, taksat dhe shpenzimet.

2.2 Kontrata e huase hyn në fuqi pas nënshkrimit nga huadhënësi, nga njëra anë, nëpërmjet personit të autorizuar, dhe, nga ana tjetër, nga huamarrësi personalisht.

2.3 Kontrata e huase mund të ndryshohet, duke përfshirë afatin e shlyerjes si dhe lidhjen e kontratave shtesë, sipas kushteve te dakordesuara nga palët, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, përveç sa parashikohet në këtë Kontratë.

2.4 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, huamarrësi pranon se është informuar plotësisht rreth kushteve të përgjithshme të huasë, përfshi penalitetet në rastet e vonesave në pagimin e kësteve, të drejtat dhe detyrimet e huamarrësit dhe huadhënësit, dhe se bie dakord se këto kushte janë të arsyeshme dhe proporcionale me rrezikun dhe shpenzimet e bëra nga huadhënësi.

2.5 Në çdo rast, kjo kontratë dhe Kontrata Specifike të Huase Personale dhe /ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta lëshohet në dy (2) kopje, nag nje per secilën palë me fuqi të njëjtë ligjore.

2.6 Huamarrësi pranon se huaja do te perdoret vetem per qellimin e permdur në Kerkesen per Hua.

2.7 Kushtet e kësaj Kontrate do të zbatohen dhe interpretohen në përputhje me njera tjetren, me Kontraten Specifike të Huase Personale ose me Kontraten e Huase per Blerje te Vecanta dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë të veçantë me Kodin Civil.

Neni 3. Kërkesa për Kredi

3.1 Për të marrë një Hua, huamarrësi duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim në formën e miratuar nga Huadhënësi. Kërkesa duhet të plotësohet personalisht nga huamarrësi dhe eshte pjese perberese e kesaj kontrate dhe eventualisht e Kontrates Specifike të Huase Personale ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta. Huadhënësi ka të drejtë të krijojë, të modifikojë kërkesat per hua sipas formatit te pershtatshem per te, e t'i kërkojë huamarrësit plotësimin e atij formati.

Neni 4. Levrimi i Huase dhe perdorimi i saj

4.1 Përfundimi i kredisë deklarohet nga përfaqësuesi zyrtar i kredidhënësit vetëm në formë të shkruar.

4.2 Pas përfundimit të kredisë, kredimarrësi ka të drejtën që, nëpërmjet një kërkesë, të kërkojë kredi shtesë. Kredidhënësi ka të drejtë të miratojë kërkesën dhe të japë kredi sipas kontratës së sapombyllur, pa nënshkrimin e një kontrate të veçantë shtesë. Palët bien dakord se akti ligjor për kredinë shtesë mund të konkludohet nëpërmjet komunikimit me e-mail, SMS, në formën dhe mënyrën e përcaktuar më parë dhe për të cilën është rënë dakord nga palët.

Kredia shtesë ka të njëjtat kushte me kontratën e përfunduar, duke përfshirë formën, subjektet. Nëse kredidhënësi pranon kërkesën e kredimarrësit për kredi shtesë, ai duhet t'i njoftojë kredimarrësit grafikun e shlyerjes dhe, nëse ka, edhe kushtet e tjera të rëndësishme.

4.3 Kredia do të paguhet nga kredidhënësi, zakonisht brenda 1 (një) dite pune nga përfundimi i kredisë së parë ose miratimi i aplikimit për shtesë kredie, dhe do të transferohet në llogarinë bankare të kredimarrësit ose ne llogarine per te cilen palet kane rene dakort dhe qe ndodhet në Kontratën Specifike te Kredise

4.4 Kredimarrësi ka të drejtë të aplikojë për kredi dhe pranon t'i transferohet shumta e kredise direkt në llogarinë bankare të personit ose subjektit të tretë, i cili nuk është palë e kësaj kredie, por me të cilin kredidhënësi ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi për kreditimin e konsumatorit. Në këtë rast, kredimarrësi paguan periodikisht këstet e kredise sipas grafikun te kontraten specifike ne numrin e llogarise te kredidhënesit, specifikuar ne kontrate.

4.5 ICA do t'i akordojë kredimarrësit shumën e kredise, duke respektuar ligjet dhe rregullat e autoriteteve monetare. Kredia konsiderohet e dhënë kur kredidhënësi ka kryer transaksionin e pagesës së kredisë nga llogaria e tij në interes të kredimarrësit. ICA rezervon te drejten per te mos e levruar kredine, nese pas verifikimit të informacionit të marrë nga aplikuesi ka arsye të besueshme për të dyshuar në riskimin e kredise. Refuzimi i kredimarrësit për të tërhequr/përdorur kredinë, nuk e shkarkon atë nga detyrimi i kthimit të kredisë sipas kushteve të kontratës së kredisë, përfshi interesat, komisionet dhe çdo kosto tjetër parashikuar në Kontratë.

4.6 Kredidhënësi nuk është përgjegjës për vonesat që krijohen në marrjen, përpunimin apo pranimin e kredisë nga një llogari bankare apo institucion tjetër në të cilën ndodhet llogaria e kredimarrësit, shkaktuar prej tyre.

4.7 Kredidhënësi nuk është përgjegjës dhe nuk përgjigjet për kostot ose tarifat e vendosura nga banka për hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarisë së kredisë së kredimarrësit, transferimin e pagesave bankare nga kredimarrësi tek kredidhënësi dhe çdo kosto tjetër të përcaktuar nga banka.

4.8 Kredia perdoret nga kredimarrësi dhe çdo falsifikim, ndryshim, veprim i kunderligjshem apo abuzim ne menytrat e terheqjes; çdo perdorim ligjor ose jo i numrit te kodit personal te llogarise se tij, si edhe shperdorimet nga organet dhe perfaqesuesit e tij, rendojne mbi kredimarrësin dhe per rrjedhoje çdo pagese e bere nga ICA ne kushtet e mesiperme, por pa u kufizuar vetem ne to, konsiderohet e ligjshme dhe perben detyrim per kredimarrësin, sikurse edhe çdo transaksion qe bazohet ne terheqjen elektronike, ne çeqe, ne urdhra te cilat jane te falsifikuar.

Neni 5. Shlyerja e huasë dhe pagesat për huamarrësin

5.1 Pas pagesës së huasë nga llogaria bankare e huadhënësit në interes të huamarrësit, huamarrësi merr përsipër t'i paguajë huadhënësit huanë, interesin dhe komisionin e parashikuar në kontratën e huasë, në datën dhe në shumën e caktuar në bazë të grafikun e shlyerjes.

5.2 Nëse data e pagesës bazuar në grafikun e shlyerjes së huasë, bie në ditë pushimi, data e pagesës shtyhet për ditën e mëpasshme të punës.

5.3 Të gjitha pagesat që rrjedhin nga Kontrata e Huasë huamarrësi i kryen në një nga llogaritë bankare të huadhënësit. Huamarrësi nuk kryen asnjë pagesë me para në dorë dhe huadhënësi nuk pranon shlyerjen e huasë apo pagesat e tjera në cash.

5.4 Huamarrësi është përgjegjës për shlyerjen e huasë së bashku me të gjitha kostot/shpenzimet e parashikuara në Kodin Civil dhe në kontratën e Huasë.

5.5 Huamarrësi ka te drejte te kryeje ne çdo kohe, edhe para afatit te maturimit, shlyerje te pjesshme ose te plote te detyrimeve te tij te lindura nga kontrata e huase.

HUADHENESI _____

HUAMARRËSI _____

Ne rastin kur huamarresi vendos të realizojë shlyerjen e te gjithë ose një pjesë të principalit, pa respektuar afatet e percaktuara ne kontraten e huasë, ai ka detyrimin të njoftojë në mënyrë të menjëhershme ICA dhe të kërkojë shumën aktuale të mbetur për mbylljen e huasë. Në këtë rast huamarresi ka detyrimin të paguajë të gjithë shumën e marrë hua, si dhe komisionet, kostot dhe detyrimet e tjera të parashikuara në kontratën e huasë, përfshi penalitete për vonesat e shkaktuara. Interesi për pjesën e mbetur të huasë, për këstet e pashlyera deri në momentin e njoftimit të huadhënësit për shlyerjen e parakohshme të huasë, falen.

5.6 Në rast të maturimit, Huamarresi do te ripaguaje ne favor te ICA huanë, për llogari te principalit, interesin, komisionin dhe shpenzimet e lidhur me të, te lira dhe te pazbritshme nga ndonje tatim, detyrim, takse e tashme apo e ardhshme, apo edhe detyrime te tjera.

Neni 6. Rastet e mospermbushjes dhe te kthimit te plote te huase

6.1 Ne rastet e verifikimit te ndonjerit nga kushtet e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to, ICA ka te drejte te ndermarre te gjitha veprimet ligjore te aplikueshme per rastin dhe/ose te kerkoje zgjidhjen e kontrates dhe rikthimin e principalit dhe interesave te akumuluar, si edhe te penaliteteve, komisioneve, shpenzimeve, detyrimeve te perlllogaritura dhe pagueshme ndaj ICA:

a. Huamarresi nuk paguan 3 (tre) keste te njepasnjeshme brenda afateve te parashikuara ne kete kontrate.

b. Kur huamarresi nuk ka respektuar dhe /ose ka shkeluar parashikimet e kontratës/ave specifike.

c. Faktet juridike, deklaratat, pohimet, miratimet dhe çdo dokument tjetër i dorezuar nga huamarresi nuk është i vertetë ose nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe në kohën e parashikuar kontratë huasë dhe në ligj.

d. Veprimet dhe sjelljet e huamarresit janë haptas në kundërshtim me ligjin dhe kontratën/at e huasë së nënshkruar me ICA.

e. Gjendja financiare e Huamarresit është keqesuar aq sa e bën të pamundur shlyerjen e detyrimit ndaj ICA.

f. Paraqet vështirësi financiare si rezultat i proceseve hetimore, gjyqësore , permbarrimore apo humbjes se papritur te punes.

6.2 Në rast se huamarresi ka vonuar pagesën për këstin e radhës, huadhënësi e kontakton në numrat e kontaktit që ndodhen në Kontratë dhe e njofton për vonesën në pagesë si dhe për penalitet që rrezikon të paguajë për të. Mospranimi për të kontaktuar me huadhënësin pavarësisht arsyeve, nuk ka efekt juridik dhe konsiderohet që huamarresi e ka marrë njoftimin për vonesën.

6.3 Në rast se huamarresi vonon pagesën e kështit të rradhes ose paguan pjesërisht atë, ditën e tretë njoftohet nga huadhënesi me ane te telefonit per kete vonese dhe paralajmërohet per penalitetet qe do te zbatohen ne rast mospagese te menjehershme te shumes se papaguar. Ne ditën e parë të vonesës në pagesë nga data e përcaktuar në grafikun që ndodhet në Kontratën Specifike të Huasë, huadhënësi fillon përlllogaritjen e penalitetit për vonesë në masën 0.85% ne dite te shumes se kështit te papaguar, llogaritur nga data kur pagesa është bërë e kërkueshme. Ne ditën e 13te te voneses huadhënesi njofton huamarresin nëpërmjet një letre për vonesën e krijuar dhe shumën e detyrimit të akumuluar në të cilin përfshihet shuma e kështit të papaguar, interesi dhe komisioni për shumën e kështit, gjobën për çdo ditë vonesë llogaritur si më lart, si dhe dëmin kontraktual. Për kete njoftim Huamarresi është i detyruar t'i paguajë Huadhënesit një shperblim qe i shtohet detyrimeve te tjera në shumën 1.500 lekë.

6.4 Në rast se huamarresi është vonuar në pagimin e kështit të radhës deri në 20 ditë, llogaritur nga data kur pagesa është bërë e kërkueshme, ai është në vonesë, duke mos përmbushur detyrimin e kërkueshëm, sipas nenit 481 të Kodit Civil dhe përcaktimit në Kontratë. Huadhënësi njofton huamarresin për vonesën dhe pasojat e saj nëpërmjet telefonates ne numrin e kontaktit qe ndodhet ne kontrate. Ne ditën e 26 te voneses, huadhënesi dërgon një letër ku i rikujton huamarresit penalitetet si dhe e njeh me shumën që detyrohet të paguajë pas aplikimit të penalitetit për vonesën pas llogaritjes. Me marrjen e njoftimit, huamarresi detyrohet të paguajë përveç shumës së kështit të radhës edhe penalitet/kamatat për çdo ditë vonesë, llogaritur 0.85% ne dite te shumes ne vonese. Për kete njoftim Huamarresi është i detyruar t'i paguajë Huadhënesit një shperblim qe i shtohet detyrimeve te tjera në shumën 1.500 lekë.

6.5 Kur huamarresi është në vonesë, deri në 32 ditë kalendarike, llogaritur nga data e detyrimit të përcaktuar në kontratë për shlyerjen e huasë, huadhënësi telefonon huamarresin duke i rikujtuar vonesën dhe detyrimet që rrjedhin prej saj. Ne rast mospagese ne ditën e 37 huadhënesi i dërgon huamarresit njoftimin e tretë në të cilin e paralajmëron për përfundimin e kontratës. Njoftimi bëhet me letër në të cilën huamarresi njihet edhe llogaritjen e shumës së penalitetin të vendosur në bazë të kontratës për çdo ditë vonesë ne masen 0.85% ne dite te shumes se papaguar, si dhe penalitet kontraktuale dhe dëmi kontraktual për njoftimet e bëra. Për kete njoftim Huamarresi është i detyruar t'i paguajë Huadhënesit një shperblim qe i shtohet detyrimeve te tjera në shumën 1.500 lekë.

6.6 Në rast se huamarresi është në vonesë mbi 47 ditë kalendarike nga dita e caktuar në kontratë për pagesën e kështit, huadhënësi deklaron menjëherë shumën totale të debitit dhe njofton huamarresin për përfundimin e kontratës në mënyrë të njëanshme. Penaliteti për huamarresin llogaritet në shumën 30% të shumës së mbetur, për ndërprerjen e menjëhershme e kontratës, Huadhënësi njofton huamarresin me anë të një letre, në lidhje me ndërprerjen e parakohshme dhe në mënyrë të njëanshme të Kontratës si dhe për shumën që huamarresi detyrohet të paguajë. Huamarresit i bëhet me dije se shlyerja e plotë e huasë duhet të bëhet brenda trembedhjetë ditëve pas dërgimit të njoftimit. Shuma totale për t'u paguar nga huamarresi llogaritet: (i) shuma e huasë së papaguar (principal) (ii) interesi i papaguar (iii) komisioni i papaguar lidhur me kontratën e huasë, kamatë/vonesë në masën 0.85% e shumes në vonesë (iv) dëmi kontraktual për dërgimin e njoftimeve në shumën 1.500 lekë për çdo njoftim , dhe (v) penaliteti për ndërprerjen e hershme të kontratës së huasë në shumën prej 30% të shumës së marrë hua.

6.7 Në ditën e 60 kur huamarresi është me vonesë telefonohet dhe njoftohet se brenda 30 diteve nga ky njoftim duhet të shlyej te gjitha detyrimet e lindura nga kontrata perfshirë edhe penalitetet e llogaritura deri në ditën e shlyerjes. Huamarresi paralajmërohet se pas mbarimit të këtij afati do te nisin procedurat e ekzekutimit te detyrueshem

6.8 Në rast se të dhënat e paraqitura nga huamarresi në aplikimin e huasë provohet se janë krejtësisht apo pjesërisht të paplota/pasakta, huadhënësi ka të drejtë të zgjidhe në mënyrë të njëanshme Kontratën dhe ka te drejte qe brenda 10 (dhjetë) ditësh t'i paguhet (i) shuma e papaguar të huasë (ii) interesi i papaguar (iii) komisioni lidhur me kontratën e huasë, kamatën (iv) penalitetin/et llogaritur për çdo ditë vonesë si dhe dëmet kontraktuale për dërgimin njoftimeve (vi) dëmi kontraktual shkaktuar nga ndërprerja e marrëveshjes së huasë në shumën prej 30% të huasë së papaguar. Pagimi i plotë i interesit dhe/ose dëmet kontraktuale nuk e çlirojnë huamarresin nga detyrimet që rrjedhin nga kontrata e huasë dhe nuk e kufizon të drejtën e huadhënësit për të bërë kërkitime të tjera për të mbrojtur të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate, Kontratës Specifike dhe legjisllacionit në fuqi.

6.9 ICA ne rastin e aplikimit te këtij neni, ka te drejte, por pa u kufizuar ne to:

a. T'i drejtohet Gjykates me kerkesen per leshimin e urdherit te ekzekutimit ne baze te nenit 510 te K.Pr.C;

b. Te filloje ekzekutimin e detyrueshem te huase;

c. Huamarresi do te perballoje te gjitha kostot dhe shpenzimet administrative dhe gjyqësore, noterizimet, komisionet, tarifat per negocim;

d. Huamarresit do te vazhdojne t'i llogariten interesa dhe penalitetet sipas percaktimeve te kesaj kontrate huasë edhe gjate ekzekutimit te detyrueshem, deri ne kthimin e plote te te gjitha shumave qe ai detyrohet huadhënësit.

6.10Efektet juridike te kontrates shtrihen tek trashëgimtarët me titull universal, sipas rregullave te Kodit Civil. Trashëgimtari i huamarresit njoftohet për te drejtat dhe detyrimet që i lindin nga kjo kontratë dhe brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit ka detyrimin të fillojë ekzekutimin e detyrimeve të lindura nga kjo kontratë.

Neni 7. Kontrata e Huasë SMS-CASH CREDIT

7.1 Kontrata e kredisë "SMS-CASH CREDIT" do të jetë në dispozicion të kredimarrësit vetëm pas marrjes së të paktën një kredie në kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë dhe në kontratën specifike.

HUADHËNESI _____

break_doc_page

Kjo kontratë bëhet aktive pas dërgimit të një kërkesë nëpërmjet SMS, letër, telefonit nga ana e kredimarrësit tek kontaktet e kredidhënësit.

HUAMARRËSI _____

7.2 Marrëveshja e kredisë "SMS-CASH CREDIT" është një kontratë kredie e veçantë që quhet e nënshkruar me nënshkrimin e kontratave paraardhëse të kredisë midis kredidhënësit dhe kredimarrësit.

7.3 Në kontratën e kredisë "SMS-CASH CREDIT" përdoren mënyra dhe rrugë komunikimi të ofruara nga sistemet moderne të komunikimit mobil, përkatesisht shërbimet e SMS-CASH ofruar nga operatorët celularë. SMS-CASH është shërbim celular që lejon dërgimin dhe marrjen e mesazheve tekst nga telefoni juaj celular, duke përdorur mesazhe me tekst nga menuja e telefonit për të dërguar mesazhin e shkruar në numrin e telefonit celular të marrësit. Shkëmbimi i mesazheve mes kredidhënësit dhe kredimarrësit që konfirmon pëlqimin dhe pranimin reciprok për zbatimin e kontratës "SMS-CASH CREDIT" i hap rrugë përmbushjes së veprimeve të mëvonshme të parashikuar në pikat e 7.8 dhe në vazhdim të këtij neni.

7.4 Formulari i kontratës së kredisë "SMS-CASH CREDIT" hartohet nga kredidhënësi dhe i dërgohet kredimarrësit me ofertën përkatese. Oferta e kontratës së kredisë "SMS-CASH CREDIT" i dërgohet me SMS-CASH, ose me letër me postë kredimarrësit. Oferta duhet të përmbajë tekstin e kontratës, shumën maksimale që kredimarrësi mund të kërkojë. Shuma maksimale e kredisë që mund të kërkojë kredimarrësi, vendoset në mënyrë të njëanshme nga kredidhënësi.

7.5 Pranimi i ofertës nga ana e kredimarrësit konfirmohet me një SMS-CASH për Text SMS në numrin xxxxxx. Teksti do të përmbajë: kodin numerik personal i kredimarrësit dhe shumën e kredisë së kërkuar. Shuma e kërkuar nuk duhet të kalojë shumën maksimale të përcaktuar nga kredidhënësi.

7.6 Pas pranimit nga ana e kredimarrësit të ofertës dhe dërgimit të SMS-CASH me të dhënat e përcaktuara në pikës 7.5 të këtij neni, kredidhënësi konfirmon me sms në nr e telefonit të kredimarrësit nëpërmjet tekstit "Kërkesa juaj është pranuar. Shuma e kredisë është zzzzzzz lekë. Shuma totale për t'u kthyer/ rimbursuar iiiiii lekë, data per rimbursimin dd: mm: yy. Nëse pranoni ofertën, konfirmoni me PO, ku zzzzzzz është shuma e kredisë së dhënë nga kredidhënësi dhe që jo domosdoshmërisht përputhet me shumën e kërkuar, iiiiii është shuma totale për shlyerjen e kredisë.

7.7 Pas marrjes me SMS nga kredidhënësi, kredimarrësi dërgon një SMS në numrin nnnnnnn = CASH me tekst "PO", nëse e pranon ofertën. Nëse Kredimarrësi nuk pajtohet me shumën e kredisë nuk kthen përgjigje, ose kthen përgjigje negative "JO".

7.8 Pas marrjes së SMS-CASH nga kredimarrësi me tekstin "PO", kredidhënësi transferon shumën e kredisë në llogarinë bankare të caktuar nga kredimarrësi. Qëllimi i dërgimit të shumës tregohet në transfertë me kodin "SMS-CASH CREDIT", ku përfshihet nr. i Kontratës, kodin numerik personal e kredimarrësit dhe data e dërgimit të SMS-CASH me tekst "PO" nga ana e kredimarrësit, që konfirmon lidhjen e kontratës.

7.9 Pas transferimit të shumës së kredisë në llogarinë bankare të caktuar nga kredimarrësi, kredidhënësi dërgon një SMS-CASH tek nr. i kredidhënësit me tekst: "Shuma e kredisë është transferuar në

llogarinë tuaj bankare nr. xxxxx, të Bankës BBBB", ku xxxxx është llogaria bankare e dhënë nga kredimarrësi, BBBB është Banka në llogarinë e përmendur.

7.10 Kredimarrësi pranon, pa asnjë konfirmim me shkrim, vlefshmërinë e të gjitha detyrimeve të pagesave që rrjedhin nga kontrata e kredisë "SMS-CASH CREDIT", dhe që pajtohen me të gjitha kushtet e kredisë treguar në Kontratën e Kredisë.

7.11 Brenda 48 orëve pas transferimit të shumës së kredisë në llogarinë e kredimarrësit, kredidhënësi dërgon në adresën e treguar në kërkesën për kredi të kredimarrësit një kopje të printuar të sistemit elektronik të përpunimit automatik të kredisë.

7.12 Kredia dhënë sipas Kontratës së Kredisë "SMS-CASH CREDIT", jepet vetëm për një periudhë prej 30 ditësh (ditë kalendrike), llogaritur nga data e dërgimit të SMS me tekst "PO" nga ana e kredimarrësit, që konsiderohet edhe momenti i lidhjes së kontratës. Kredia paguhet nga kredimarrësi me një pagesë të vetme ditën e tridhjetë (30). Norma e interesit të kredisë e aplikueshme për kontratën "SMS-CASH CREDIT" është 0% në vit. Tarifa e komisionit është njoftohet nepermjet SMS dhe paguhet ditën e pagesës së kredisë (30 ditëve kalendrike nga data e miratimit të kontratës së kredisë, si përshkruhet më sipër).

Neni 8. Njoftimi Zyrtar midis Paleve

8.1 Te gjitha te dhenat e kontaktit te huamarresit deklarohen se jane te sakte, perfshi, adresen fizike, elektronike, numrat e telefonit, etj. Komunikimi i kryer me secilin nga keto mjete, pranohet i vlefshem per qellimet e kontrates. Ato pranohen te vlefshme edhe per qellimet e njoftimit te akteve zyrtare te juridiksionit gjyqesor, apo cdo organi tjeter procedues. Huamarresi heq dore nga cdo pretendim me natyre proceduriale ne lidhje me mosnjoftimet e sakta perpara cdo organi gjyqesor apo procedimi nese njoftimet provohet se jane derguar sipas kontakteve te dekaluara ne kontrate

8.2 Huamarresi deklaron dhe pranon qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne adresat e dhena prej tij dhe qe ndodhen ne kete kontrate do te konsiderohen si te marra nga ai.

8.3 Huamarresi eshte i detyruar qe te njoftoje menjehere cdo ndryshim ne adresen e tij. Per sa kohe qe ai nuk ka njoftuar adresen e re, njoftimet do te quhen si te bera dhe huamarresi nuk ka te drejte dhe heq dore nga cdo pretendim ne lidhje me njoftimet e bera ne adresen e deklaruar prej tij sipas kesaj kontrate

Neni 9. Dispozita te tjera

9.1 Informacioni ne lidhje me kete Kontrate dhe Kontratën Specifike të Huasë raportohet pranë Bankes se Shqiperise ne cilesine e Autoritetit Mbikqyres.

9.2 Kredimarrësi jep pëlqimin që të dhenat e tij të procesohen dhe të ruhen edhe jashtë shqiperise ne nje kompani me seli dhe license ne Bashkimin European per te procesuar te dhena

9.3 Kjo kontrate së bashku me Kontratën Specifike të Huase Personale dhe/ose te Kontrates se Huase per Blerje te Vecanta, ne baze te nenit 510/d te Kodit te Procedures Civile, eshte titull Ekzekutiv.

9.4 Gjykata kompetente per shqyrtimin e cdo ceshtje qe buron nga kjo kontrate eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

9.5 Kjo kontrate u hartua ne 2 (dy) kopje me permbajtje te njejte dhe pranohet me vullnetin te plote nga palet, vullnet i shprehur me anë të nënshkrimit të saj prej tyre.

HUADHENESI _____

"IuteCredit ALBANIA" Sh.a.

HUAMARRESI _____

Emër, Mbiemër, Firmë

Huamarrësi deklaron se ka lexuar, kuptuar dhe miratuar të gjitha dispozitat e kësaj Kontrate dhe per efekt te nenit 686 te Kodit Civil, Huamarrësi deklaron se miraton veçmas me shkrim dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 te kësaj Kontrate.

HUAMARRESI _____